

VENDIM
Nr. 35, datë 25.4.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Elsa Toska,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahimimi,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datat 2.4.2024 dhe 25.4.2024, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 20 (Sh) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Shoqëria “Iliad 1” sh.p.k., përfaqësuar nga administratorja Natasha Lamaj.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Cyme Manoku,

Mirvjena, Martin, Meriban, Miranda, Edmond, Edlira, Eduard, Nenole, Eliza, Albert, Xhaferson, Valbona, Mimoza, Hader, Lavdie, Drita Bedini, në mungesë.

Budjon, Agron, Zana, Fatmira, Vladimir Goxhaj, në mungesë.

Zhaneta Bici, në mungesë.

Bashkia Vlorë, në mungesë.

Ministria e Ekonomisë dhe Financës, në mungesë.

Avokatura e Shtetit, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-1540 (224), datë 19.4.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 43, 131, pika 1, shkronja “P”, 134 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuases, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Cyme Manoku, e cila ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve të subjekteve të interesuara, Bedini, Goxhaj dhe Bici, subjekteve të interesuara Bashkisë Vlorë, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financës (*MEF*) dhe Avokaturës së Shtetit, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësja, shoqëria “Iliad 1”, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.) me seli në qytetin e Vlorës, e cila ka për objekt veprimtarie aktivitete të tilla, si: administrim kënde lojërash, menaxhimin e bareve dhe restoranteve të hapura ose të mbyllura, hapjen dhe menaxhimin e hoteleve, moteleve dhe komplekseve turistike. Ajo është krijuar nga ndarja e shoqërisë “ILIAD” sh.p.k. dhe ka trashëguar prej saj disa të drejta e detyrime.

2. Një prej të drejtave të trashëguara lidhej me qiramarrjen e një trualli prej 21.000 m² në lagjen Pavarësia, Vlorë sipas vendimit nr. 102, datë 24.10.2001, të Këshillit Bashkiak Vlorë. Mbi bazën e

këtij vendimi, ndërmjet ish-Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), sot MEF-ja, dhe kërkueses është lidhur fillimisht me afat 10-vjeçar kontrata e qirasë nr. 2945 rep., nr. 154 kol., datë 4.6.2002. Ndërsa me dy anekse, kontratat nr. 3873 rep., nr. 2079 kol., datë 1.7.2005 dhe nr. 3584 rep., nr. 636 kol., datë 5.8.2006, afati është zgjatur në 20 vjet, sipërfaqja e truallit është rillogaritur në 11.890 m² dhe vlera mujore e qirasë është përcaktuar 360.000 lekë. Sipas nenit 4 të kontratës së qirasë, qiradhënësi garantonte qiramarrësin për posedimin dhe gëzimin e qetë të sendit nga të tretët.

3. Përpara lidhjes së kontratës së qirasë, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronës (KKKP), Vlorë, me vendimin nr. 79, datë 16.5.1995, ka vendosur njohjen e së drejtës së pronësisë një subjekti të shpronësuar dhe kthimin e pasurisë truall prej 2400 m² në lagjen "Pavarësia" trashëgimtarëve të tij Mirvëna Bedini, Martin Bedini, Meriban Bedini, Miranda Bedini, Edmond Bedini, Edlira Bedini, Eduard Bedini, Nenole Bedini, Eliza Bedini, Albert Bedini, Xhaferson Bedini, Valbona Bedini, Mimoza Bedini, Hader Bedini, Lavdie Bedini, Drita Bedini (subjektet e interesuara Bedini), Budjon Goxhaj, Agron Goxhaj, Zana Goxhaj, Fatmira Goxhaj, Vladimir Goxhaj (subjektet e interesuara Goxhaj), Zhaneta Bici (subjekti i interesuar Bici) dhe Cyme Manoku (subjekti i interesuar Manoku). Një pjesë e këtij truall mbivendosej me truallin e marrë me qira nga kërkuesja.

4. Për shkak të mbivendosjes së pronave, subjekti i interesuar Manoku në datën 17.2.2004, ka paraqitur padi në gjykatë ndaj kërkueses, MZHETTS-së dhe Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronës (AKKP), me objekt rivendikimin e truallit që posedohej nga kërkuesja. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 2782, datë 12.10.2012, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së qirasë për pjesën që lidhej me truallin që kërkohej të rivendikohej dhe kthimin e sipërfaqes prej 1931.9 m². Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 266, datë 23.5.2013, ndërsa Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2022-2810, datë 18.10.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses.

5. Në kushtet kur vendimi gjyqësor i formës së prerë e detyronte kërkuesen të kthente një pjesë të truallit, ajo ka paraqitur në gjykatë kërkesë për sigurimin e padisë, duke kërkuar pezullimin e ekzekutimit të tij. Kërkesa është pranuar me vendimin nr. 292, datë 22.8.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Në vijim, kërkuesja ka paraqitur padi me objekt detyrimin e subjekteve të interesuara Manoku, Bedini, Goxhaj dhe Bici, në cilësinë e trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar, që t'i paguanin asaj shpenzimet e nevojshme dhe të dobishme të kryera për truallin prej 1931.9 m² në vlerën 3,709,856 lekë dhe njohjen e së drejtës së saj për mbajtjen e truallit deri në përmbushjen e këtij detyrimi, si dhe detyrimin e MZHETTS-së ta dëmshpërblente me vlerën 7,636,812 lekë si humbje e pësuar dhe 23,242,168 lekë si fitim i munguar. Në këtë proces gjyqësor, trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar kanë paraqitur kundërpadi me objekt shpërblim dëmi jashtëkontraktor nga përdorimi i pronës.

6. Në përfundim të gjykimit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 379, datë 2.3.2015, ka vendosur: i. pranimin e pjesshëm të padisë, duke detyruar MZHETTS-në të shpërblente kërkuesen në vlerën 3.709.856 lekë për dëmin pasuror dhe në vlerën 23.242.168 lekë për fitimin e munguar; ii. rrëzimin e padisë për sa u përket kërtimeve ndaj trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar; iii. pranimin e kundërpadisë, duke detyruar kërkuesen t'u paguante trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar vlerën e përdorimit të truallit dhe kamatëvonesat prej datës 23.5.2013 (kur vendimi gjyqësor për kthimin e truallit të marrë formë të prerë) deri në ekzekutimin e tij. Kërkuesja dhe Avokatura e Shtetit kanë paraqitur apel ndaj këtij vendimi.

7. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 1001, datë 29.9.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit, me arsyetimin se ai ishte marrë në zbatim të drejtë të ligjit procedural dhe material. Kundër vendimit kanë ushtruar rekurs kërkuesja dhe subjektet e interesuara, Avokatura e Shtetit dhe MZHETTS-ja. Gjithashtu, secili nga tre rekursuesit, veçmas, ka kërkuar nga Gjykata e Lartë edhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor. Këto kërkesa janë pranuar nga Gjykata e Lartë me vendimet nr. 175, datë 13.4.2017 (për Avokaturën e Shtetit), nr. 181, datë 13.4.2017 (për MZHETTS-në) dhe nr. 263, datë 7.6.2018 (për kërkuesen).

8. Subjekti i interesuar, Manoku, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë dy kërkesa, të datave 24.9.2018 dhe 5.7.2021, për revokimin e vendimit të pezullimit nr. 263, datë 7.6.2018, të dhënë nga

Gjykata e Lartë bazuar në kërkesën e kërkuases. Të dyja kërkesat nuk janë pranuar nga Gjykata e Lartë me vendimet nr. 263/1, datë 6.11.2018 dhe nr. 263/2, datë 5.7.2021, me të njëjtin arsyetim se kërkesa për revokim nuk përmbante shkaqet e parashikuara nga neni 479, pika 6, i Kodit të Procedurës Civile (KPC) dhe nuk shoqërohej nga ndonjë rrethanë ose provë e re.

9. Në përfundim, mbi bazën e tre rekurseve, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1540(224), datë 19.4.2023, ka vendosur: i. ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë për pjesën që dispononte detyrimin e MZHETTS-së për pagimin e dëmit në formën e fitimit të munguar, duke e rrëzuar padinë për këtë kërkim; ii. lënien në fuqi të vendimit për pjesët e tjera; iii. mospranimin e rekursit të kërkuases për shkak të paraqitjes së tij jashtë afatit ligjor.

10. Në datën 7.8.2023, kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës në datën 6.11.2023, bazuar në nenin 32, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

11. Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 503, datë 13.9.2017, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”, i ka kaluar MFE-së kompetencat e MZHETTS-së. Për këtë shkak në tekstin e këtij vendimi, emrat e këtyre institucioneve janë përdorur në përkëmbim respektiv të njëri-tjetrit, duke iu referuar kohës që janë kryer veprime prej tyre.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. *Kërkuësja*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

12.1 *E drejta e aksesit*, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të saj me arsyetimin se ai ishte paraqitur jashtë afatit ligjor, edhe pse kërkuësja kishte zënë afatin në datën 31.10.2016, ditë e hënë, me anë të një rekursi të shkurtuar, si rezultat i vonësës së arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë. Kërkuësja, pasi është njohur me vendimin e arsyetuar, në datën 6.3.2017, ka paraqitur rekurs të plotë.

12.2 *E drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi i njëjti trup gjykues i Gjykatës së Lartë që ka dhënë vendimin e kundërshtuar, ka vendosur mospranimin e rekursit në çështjen tjetër gjyqësore për kthimin e sendit, ku kërkuësja ishte e paditur. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Gjykatës së Lartë kishte papajtueshmëri në rastin konkret, bazuar në nenet 72, pika 4 dhe 72, pika 6, të KPC-së, pasi mosmarrëveshja ishte midis të njëjtave palë dhe për të njëjtin objekt material - truall.

12.3 *Standardi i arsyetimit të vendimit*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është dukshëm kontradiktor. Nga njëra anë, arsyetohet se moszgjatja e kontratës së qirasë deri në afatin ligjor të kontraktuar cenon pritshmërinë e ligjshme të qiramarrësit dhe sjell dëm që pakëson fitimin e kërkuases deri në vitin 2022, ndërsa, nga ana tjetër, se nuk ka vend për shpërblim dëmi pasuror në formën e fitimit të munguar në shumën 23.242.168 lekë, pasi vendimet e gjykatave kanë qenë të pezulluara dhe kërkuësja ka vijuar aktivitetin ekonomik duke realizuar fitimet nga ky aktivitet. Ndërkohë, trualli është dorëzuar nga kërkuësja në datën 29.3.2017, te subjektet e interesuara Bedini, sipas veprimeve të përmbareshit gjyqësor, në zbatim të titullit ekzekutiv vendimit nr. 2782, datë 12.10.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me objekt kthimin e sendit.

13. ***Subjekti i interesuar, Cyme Manoku***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

13.1 Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit është i pabazuar. Gjykata e Lartë ka arsyetuar drejt se nga data e dhënies së vendimit 29.9.2016, deri në datën e paraqitjes së rekursit ka kaluar afati ligjor 30-ditor. Rekursi i shkurtuar është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndërkohë që sipas nenit 476 të KPC-së duhej të ishte paraqitur në Gjykatën e Apelit Vlorë. Rekursi i depozituar në gjykatën që nuk ka dhënë vendimin konsiderohet se nuk është paraqitur. Në mungesë të hetimit administrativ nga administrata gjyqësore e Gjykatës së Lartë Gjykata duhet ta konsiderojë të pavlefshëm rekursin e shkurtuar.

13.2 Pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme është i pabazuar. Dy çështjet gjyqësore nuk janë të njëjta, pasi kanë objekte dhe shkaqe ligjore të ndryshme. Çështja është shpallur për gjykim 30 ditë përpara datës së gjykimit dhe kërkesja nuk ka reaguar për të kundërshtuar trupin gjykues, ndaj ky pretendim ka rënë në dekadencë dhe nuk mund të shqyrtohet nga Gjykata.

13.3 Pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit* të Gjykatës së Lartë nuk qëndron. Konkluzioni i Gjykatës së Lartë se kërkesja ka vazhduar të posedojë mjediset, duke vijuar aktivitetin e saj tregtar dhe duke realizuar fitime, ndaj nuk ka vend për shpërblimin e dëmit pasuror në formën e fitimit të munguar, është i mbështetur në provat e ndodhura në dosjen gjyqësore, të cilat nuk janë objekt gjykimi në Gjykatë. Ky konkluzion nuk përbën kontradiksion, përkundrazi, është në kompetencën e Gjykatës së Lartë.

14. **Subjektet e interesuara**, Bedini, Goxhaj, Bici, Bashkia Vlorë, MEF-ja dhe Avokatura e Shtetit, nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkeses

15. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "P" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

16. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

17. Në çështjen konkrete, Gjykata vlerëson se kërkesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "P" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, pasi është palë në procesin gjyqësor për të cilin është dhënë vendimi i kundërshtuar dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

18. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive* në dispozicion, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja "P", i Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkesja i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, ajo e ka plotësuar edhe këtë kriter, pasi nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual¹.

19. Gjithashtu, Gjykata, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, çmon se kërkesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është dhënë në datën 19.4.2023, ndërsa ankimi është paraqitur në Gjykatë në datën 7.8.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

20. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, kërkesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e së drejtës së aksesit, së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe standardit të arsyetimit të vendimit.

21. Për sa i takon pretendimit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit, ajo ka argumentuar se vendimi i Gjykatës së Lartë përmban kontradikta të dukshme, sepse, nga njëra anë,

¹ Gjyqtari Ilir Toska votoi për mosplotësimin e këtij kriteri në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, me argumentin se kërkesja, megjithëse është njoftuar për përbërjen e trupit gjykues dhe ka qenë në dijeni të shkakut të pretenduar të papajtueshmërisë së gjyqtarëve të trupit gjykues (një vendimmarrje e tyre që daton 6 muaj më përpara, në një çështje ku ajo ka qenë palë ndërgjyqëse), edhe pse ka pasur mjete juridike në dispozicion, në rastin konkret kërkesën për përfundim, sipas nenit 74 të KPC-së, nuk i ka shfrytëzuar ato përpara Gjykatës së Lartë. Kërkesja nuk ka parashtruar dhe argumentuar se përse ky mjet do të ishte joefektiv në drejtim të rezultatit të pritshëm prej saj. Po kështu, ajo nuk ka parashtruar për ekzistencën e ndonjë shkakut tjetër papajtueshmërie të gjyqtarit, shkak me të cilin është njohur pas përfundimit të procesit gjyqësor të kundërshtuar. Për rrjedhojë, për sa kohë kërkesja nuk ka shteruar këtë mjet juridik, ajo konsiderohet se nuk ka shteruar mjetet efektive të ankimit përpara paraqitjes së ankimit kushtetues në lidhje me këtë pretendim.

ka arsyetuar se moszgjatja e kontratës së qirasë deri në afatin e kontraktuar cenon pritshmërinë e ligjshme të qiramarrësit, ndërsa, nga ana tjetër, se nuk ka vend për shpërblim dëmi pasuror në formën e fitimit të munguar, pasi vendimet e gjykatave kanë qenë të pezulluara dhe kërkesja ka vijuar aktivitetin ekonomik duke realizuar fitimet nga ky aktivitet. Përkundër këtyre argumenteve, subjekti i interesuar Manoku ka prapësuar se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk cenon standardin kushtetues të arsyetimit, pasi nuk ka asnjë kontradiksion, përkundrazi, konkluzionet e arsyetimit janë në kompetencën e Gjykatës së Lartë, siç ia njeh ligji. Gjykata vëren se, në thelb, argumentet e paraqitura nga palët ndërgjyqëse kanë të bëjnë me vlerësimin e fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimin e ligjit, të cilat, siç është pohuar vazhdimisht në jurisprudencën kushtetuese, janë në kompetencë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues (*shih vendimet nr. 12, datë 15.3.2023; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuësës për cenimin e standardit të arsyetimit nuk mund të merret në shqyrtim.

22. Ndërsa, lidhur me pretendimet e tjera për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe së drejtës së aksesit, të cilat janë aspekte të procesit të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, Gjykata vlerëson se ato hyjnë në juridiksionin e Gjykatës, ndaj do të analizohen në vijim.

B. Për themelën e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme

23. Kërkuësja pretendon se i është cenuar e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, duke parashtruar se i njëjti trup gjykues i Gjykatës së Lartë ka vendosur edhe mospranimin e rekursit në çështjen tjetër gjyqësore për kthimin e truallit, ku kërkuësja ishte palë e paditur. Për rrjedhojë, sipas saj, gjyqtarët e Gjykatës së Lartë duhej të kishin dhënë dorëheqjen nga gjykimi i çështjes së saj, bazuar në nenet 72, pika 4 dhe 72, pika 6, të KPC-së, pasi mosmarrëveshja ishte midis të njëjtave palë dhe për të njëjtin objekt material - truall.

24. Subjekti i interesuar, Manoku, ka prapësuar se pretendimi i kërkuësës për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme është i pabazuar, pasi dy çështjet gjyqësore kanë objekte dhe shkaqe ligjore të ndryshme. Po kështu, sipas saj, çështja është shpallur për gjykim 30 ditë përpara datës së gjykimit dhe kërkuësja nuk ka reaguar për të kundërshtuar trupin gjykues, ndaj ky pretendim ka rënë në dekadencë dhe nuk mund të shqyrtohet nga Gjykata.

25. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shihet që bëhet (*shih vendimet nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 10, datë 13.2.2017; nr. 49, datë 10.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Po kështu, Gjykata ka pohuar se respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, *testin subjektiv*, i cili, në thelb, kërkon të provuarit e faktit se bindja personale e një gjyqtari ka ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, *testin objektiv*, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme ka rëndësi. Për rrjedhojë, kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm (*shih vendimet nr. 10, datë 12.4.2022; nr. 10, datë 13.2.2017; nr. 49, datë 10.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata fillimisht vëren se lista e çështjeve civile për shqyrtim në dhomë këshillimi, ku përfshihej edhe çështja e kërkuësës, është shpallur në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në datën 3.4.2023, pra 16 ditë përpara shqyrtimit të çështjes, më 19.4.2023, duke respektuar në këtë mënyrë afatin “të paktën 15 ditë përpara” të përcaktuar nga

neni 482, pika 3, i KPC-së. Në listën e çështjeve, përveç datës së shqyrtimit, gjendet edhe informacioni për emrat e gjyqtarëve në përbërje të Kolegjit Civil që do të shqyrtonin çështjen e kërkujeses. Ndërkohë, nuk rezulton që kërkuësja të ketë ngritur ndonjë kërkesë për zëvendësimin e gjyqtarëve me pretendimin për paanshmërinë e tyre.

28. Në vijim, Gjykata konstaton se gjyqtarët të cilët kanë marrë pjesë në dhënien e vendimit të Gjykatës së Lartë, që kundërshtohet nga kërkuësja në ankimin kushtetues individual, kanë qenë, gjithashtu, pjesë e trupit gjykues të Gjykatës së Lartë që kanë dhënë vendimin në përfundim të procesit gjyqësor midis subjektit të interesuar Manoku, nga njëra anë, dhe kërkuësjes, MZHETS-ës dhe AKKP-së, nga ana tjetër, me objekt rivendikimin e truallit prej 1931.9 m², që posedohej nga kërkuësja dhe pavlefshmërinë absolute të kontratës së qirasë për këtë pjesë të truallit. Konkretisht, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2022-2810, datë 18.10.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuësjes, duke mos cenuar disponimet e gjykatave të faktit në favor të subjektit të interesuar (*shih paragrafin 4 të këtij vendimi*).

29. Duke mbajtur në konsideratë se Gjykata e Lartë në rastin e mëparshëm ka dhënë vendim mospranimi për rekursin, pra një vendim që ka shqyrtuar vetëm ekzistencën ose jo të shkaqeve ligjore në rekurs, pa vlerësuar themelin e mosmarrëveshjes midis palëve, Gjykata rithekson se paanshmëria objektive dhe subjektive e gjyqtarëve, të cilët kanë marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, nuk lë shkas për dyshime për njëanshmërinë e tyre gjatë procesit gjyqësor (*shih vendimet nr. 6, datë 2.3.2018; nr. 7, datë 10.2.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuësjes për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme është i pabazuar.

B.2. Për cenimin e së drejtës së aksesit

30. Kërkuësja pretendon se Gjykata e Lartë nuk e ka shqyrtuar rekursin e paraqitur prej saj me arsyetimin se ai është paraqitur jashtë afatit ligjor. Sipas kërkuësjes, ajo ka paraqitur rekurs të shkurtër në datën 31.10.2016 me qëllim zënien e afatit, duke qenë se vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë nuk ishte arsyetuar ende dhe, në vijim, pasi është njohur me vendimin e arsyetuar të asaj gjykate, ka paraqitur rekursin e plotë në datën 6.3.2017. Gjithashtu, kërkuësja ka parashtruar se dita e fundit për paraqitjen e rekursit ndaj vendimit të gjykatës së apelit të dhënë në datën 29.9.2016, ishte data 29.10.2016, e cila ishte e shtunë dhe sipas ligjit procedural kur afati i fundit bie në ditë pushimi, afati mbaron ditën që vjen pas asaj të pushimit, pra më 31.10.2016.

31. Subjekti i interesuar Manoku ka prapësuar se kërkuësjes nuk i është cenuar e drejta e aksesit. Sipas saj, Gjykata e Lartë ka arsyetuar drejt që rekursi i saj ishte paraqitur jashtë afatit ligjor 30-ditor, pasi rekursi i shkurtuar është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndërkohë që sipas nenit 476 të KPC-së duhej të paraqitej në Gjykatën e Apelit Vlorë. Për këtë arsye, sipas subjektit të interesuar, rekursi i shkurtuar nuk mund të konsiderohet se është paraqitur dhe mund të mos jetë akt i vërtetë, ndaj Gjykata duhet ta konsiderojë atë akt të pavlefshëm.

32. E drejta e aksesit në gjykatë garantohet nga neni 42, pika 2, i Kushtetutës, që parashikon, ndër të tjera, se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e gjykimit të drejtë dhe publik brenda afatit të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

33. Gjykata në interpretimin e kësaj norme kushtetuese ka pohuar se shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën për t'u drejtuar gjykatës, e cila nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje gjyqësore përfundimtare për mosmarrëveshjen. Nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 29, datë 1.11.2022; nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 17, datë 24.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, e drejta e aksesit mund të kufizohet kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, siç janë afatet e përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje, të cilat janë në funksion të parimit të sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 40, datë 22.12.2022; nr. 9, datë 7.2.2017; nr. 18, datë 31.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Gjithashtu, Gjykata është shprehur se është detyrë e administratës gjyqësore të njoftojë ankuesin/rekursuesin kur dokumentacioni që shoqëron ankimin/rekursin është i paplotë. Ajo ka theksuar se e drejta e ankimit, ashtu si edhe ajo e aksesit në gjykatë, nuk mund t'i cenohen individit

për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë ose gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore (*shih vendimet nr. 31, datë 3.11.2022; nr. 32, datë 22.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit Vlorë e ka shpallur vendimin në datën 29.9.2016, në prani të kërkuesses, duke njoftuar edhe afatin ligjor 30-ditor të paraqitjes së rekursit, që për kërkuessen përfundonte në datën 29.10.2016. Në kushtet kur kjo datë binte në ditë pushimi javor, e shtunë, atëherë, bazuar në nenin 147 të KPC-së, afati përfundonte në ditën e parë pas pushimit javor, të hënën më 31.10.2016. Pikërisht në këtë datë, sipas një dokumenti të paraqitur si provë në gjykimin kushtetues, kërkuessa ka depozituar aktin “rekurs i shkurtuar”, i cili është marrë në dorëzim nga administrata e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë kundrejt nënshkrimit dhe vulës zyrtare, me qëllim zënien e afatit, për sa kohë që vendimi i rekursuar nuk ishte arsyetuar ende. Në vijim, kërkuessa ka paraqitur rekursin e plotë ndaj vendimit të gjykatës së apelit në datën 6.3.2017.

36. Për sa i përket paraqitjes së rekursit të shkurtuar, Gjykata ripohon se në praktikën e punës së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm ka gjetur zbatim paraqitja dhe pranimi i akteve të ankimit, të paplota në përmbajtje, për palën që kërkon të kundërshtojë vendimin gjyqësor, por që për shkak të mosarsyetimit të tij brenda afatit ligjor nuk ka mundësi të pasqyrojë shkaqet ose të ngrejë pretendimet kundër vendimit gjyqësor të kundërshtuar. Lidhur me këtë praktikë pune, Gjykata ka vlerësuar se ajo i ka shërbyer aksesit substancial të individit në gjykatë dhe është njohur për të konsideruar të shfaqur vullnetin e individit për të kundërshtuar vendimin brenda afateve ligjore, duke i dhënë mundësinë që pasi të njihet me arsyetimin e vendimit, të plotësojë shkaqet e ankimit (*shih vendimin nr. 32, datë 3.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se kërkuessa, pas paraqitjes së rekursit, ka kërkuar në Gjykatën e Lartë edhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit. Me vendimin nr. 263, datë 7.6.2018, Gjykata e Lartë ka pranuar kërkesën, duke evidentuar shprehimisht: “Kërkuessa i është drejtuar Gjykatës së Lartë dhe në zbatim të pikës 1 të nenit 479, pika 1, të KPC-së bashkëlidhur kërkesës për pezullim gjendet edhe kopja e rekursit ndaj vendimit të gjykatës së apelit. Gjithashtu, konstatohet se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykim janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga kërkuessa, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre” (*shih faqen 4 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Po kështu, Gjykata vë në dukje se subjekti i interesuar Manoku ka paraqitur në Gjykatën e Lartë dy kërkesa, atë të datës 24.9.2018 dhe 5.7.2021, për revokimin e vendimit të pezullimit nr. 263, datë 7.6.2018, të dhënë nga Gjykata e Lartë bazuar në kërkesën e kërkuesses. Të dyja kërkesat nuk janë pranuar nga Gjykata e Lartë me vendimet nr. 263/1, datë 6.11.2018 dhe nr. 263/2, datë 5.7.2021, me të njëjtin arsyetim se kërkesa për revokim nuk përmbante shkaqet e parashikuara nga neni 479, pika 6, i KPC-së dhe se ajo nuk shoqërohej nga ndonjë rrethanë ose provë e re.

38. Në vlerësim të këtyre rrethanave, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë kur ka proceduar për kërkesat për pezullim dhe revokim të vendimit të pezullimit, nuk duket se ka vënë në dyshim pranueshmërinë e rekursit të kërkuesses, në kuptim të elementeve formale, përfshirë afatin e paraqitjes së tij.

39. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1540 (224), datë 19.4.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesses, duke evidentuar se rekursi ishte paraqitur në datën 6.3.2017 (*shih paragrafin 16 të vendimit të Gjykatës së Lartë*) dhe duke arsyetuar se “rekursi i palës paditëse shoqëria ‘Iliad 1’ sh.p.k. nuk duhet të pranohet, pasi rekursi i saj është jashtë afatit ligjor 30-ditor” (*shih paragrafin 21 të vendimit*). Në tekstin e këtij vendimi nuk përmendet fakti i paraqitjes së rekursit të shkurtuar nga kërkuessa.

40. Lidhur me këto fakte, Gjykata vëren se në dosjen gjyqësore është administruar vetëm rekursi i plotë i kërkuesses i datës 6.3.2017, ndërsa rekursi i shkurtuar i datës 31.10.2016 mungon. Në këtë pikëpamje, duket që trupi gjyqësor i Gjykatës së Lartë kur ka shqyrtuar çështjen e kërkuesses dhe ka konstatuar në dosjen gjyqësore vetëm rekursin e datës 6.3.2017, nuk ka pasur gabim faktik ose ligjor në vlerësimin se ai rekurs ishte paraqitur jashtë afatit ligjor dhe për këtë shkak duhej vendosur mospranimi i tij.

41. Megjithatë, Gjykata evidenton se kërkuessa ka paraqitur një fotokopje të rekursit të shkurtuar, që mban datën 31.10.2016, nënshkrimin e punonjësit të sekretarisë gjyqësore dhe vulën e gjykatës së shkallës së parë. Kësaj fotokopjeje kërkuessa i ka bashkëlidhur një informacion zyrtar

të lëshuar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë në datën 2.11.2023, sipas të cilit “(...) Nga verifikimi i shkresës përcjellëse nr. 2844, datë 25.7.2018 dhe shkresës së datës 6.5.2019, për përcjelljen e dosjes në Gjykatën e Lartë rezulton të jetë cituar se shoqëria “Iliad 1” sh.p.k. ka paraqitur rekurs të shkurtuar në 2 fletë dhe rekurs të plotë 10 fletë”. Shkresat e cituara i janë bashkëlidhur informacionit zyrtar.

42. Po kështu, me kërkesë të Gjykatës, me shkresën nr. 1465/1, datë 8.4.2024, e njëjta gjykatë ka informuar se në vitin 2016: i. rekursat kundër vendimeve të Gjykatës së Apelit Vlorë paraqiteshin në Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë; ii. mbi rekurse shënohej data e paraqitjes dhe më pas ato regjistroheshin në një regjistër të veçantë; iii. në regjistrin e veçantë është regjistruar vetëm rekursi i plotë i kërkuar, i paraqitur në datën 6.3.2017; iv. në aktet e mbajtura në nëndosjen e çështjes së kërkuar gjendet shkresa përcjellëse e dosjes në Gjykatën e Lartë dhe në atë shkresë përcjellëse ndodhen të inventarizuara të dyja rekursat e paraqitura nga kërkuarja 2 dhe 7 fletë, nga të cilat 2 fletë të përsëritura, ndërsa në të dyja shkresat e datave 6.5.2019 dhe 2.9.2019, për përcjelljen e akteve Gjykatës së Lartë, citohet “rekurs i paraqitur nga kërkuarja, gjithsej, 10 fletë”.

43. Në analizë të të gjitha rrethanave të çështjes, Gjykata fillimisht vlerëson se nuk qëndron prapësimi i subjektit të interesuar se rekursi i shkurtuar është paraqitur në një gjykatë jokompetente në kushtet kur gjykata e shkallës së parë pohon se sipas praktikës së kohës rekursat paraqiteshin pranë saj dhe se aktet e dosjes gjyqësore konkrete janë përcjellë nga ajo në Gjykatën e Lartë. Në vijim, Gjykata çmon se administrata gjyqësore e gjykatës së shkallës së parë ka vepruar në mënyrë të parregullt, pasi nuk ka dokumentuar në regjistrin e veçantë paraqitjen e rekursit të shkurtuar nga kërkuarja, nuk ia ka njoftuar atë palëve të tjera ndërgjyqëse dhe as nuk e ka përfshirë në aktet e dosjes gjyqësore që i është përcjellë për shqyrtim Gjykatës së Lartë. Këto mangësi në veprimtarinë e administratës gjyqësore nuk mund të rëndojnë mbi kërkuar, sepse do të krijonin një barrë të tepër ndaj saj. Për këto arsye, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuarja e ka paraqitur rekursin e shkurtuar brenda afatit ligjor, duke shfaqur vullnetin për të kundërshtuar vendimin dhe pasi është njohur efektivisht me arsyetimin e vendimit, ka plotësuar shkaqet e ankimit me anë të rekursit të plotë.

44. Mirëpo, si pasojë e veprimeve të mangëta të administratës gjyqësore të gjykatës së shkallës së parë, në drejtim të administrimit dhe përcjelljes së akteve, rekursi i shkurtuar nuk është përfshirë në dosjen gjyqësore dhe as nuk i është nënshtruar vlerësimit të Gjykatës së Lartë, me pasojë mospranimin e rekursit të plotë për shqyrtim. Në këtë mënyrë, kërkuarja është penguar në të drejtën për të pasur një zgjidhje gjyqësore përfundimtare për mosmarrëveshjen, ndaj procesi konsiderohet i parregullt. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuar për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë është i bazuar.

45. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuar për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme është i pabazuar, ndërsa pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm, dhe për këtë shkak të fundit kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-1540 (224), datë 19.4.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtuës me Kushtetutën.
 3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 25.4.2024.

Shpallur, më 20.5.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Elsa Toska, Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahim